



Planuar / Doretuar Punëdhënësi/Prifato Received/Delivory	14.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Institution Org /Unit	Nr Prot Bj Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kopësia Quantity
SKIMSHAK	1347/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.66/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.66/2022 të datës 26.01.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson avokati [redacted] me adresë, [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.66/2022 e datës 26.01.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.1504/2021 i datës 31.12.2021 i Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, duke e kthyer ankuesen si në piken 1 të këtij vendimi në pozitën e Auditorit të Brendshëm sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: NJAB 03/13 të datës 18.11.2013, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, [redacted] e punësuar në pozitën e punës Auditore e Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 26.01.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 362/2022 të regjistruar me numër A.nr.66/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1504/2021 të datës 31.12.2021 të Divizionit për Burime Njerëzore, përmes të cilit ankueses me datë 31.12.2021 i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në zbatim të Vendimit Nr.1488/2021 të datës 31.12.2021 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli, me datë 11.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 362/2022, të regjistruar me numër A.nr.66/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses të datës 22.11.2013 për pozitën Auditore e brendshme; Kërkesën e ankueses e datës 19.12.2018 për pezullim të dakorduar; Vendimin me numër Nr.prot.1026 të datës 28.12.2018 për pezullimin e statusit të nëpunësit civil; E-mailin e datës 15.01.2022 nga ankuesja; Emailin zyrtar të datës 15.01.2022; Emailin zyrtar të datës 15.01.2022; E-mailin e datës 08.12.2021; E-mailin e datës 09.12.2021; Vendimin me numër Nr.1488/2021 të datës 28.12.2021 të zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me numër Nr.1504/2021 të datës 31.12.2021 lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses; Procesverbalin me numër Nr.01-5053/18 të datës 22.11.2018; Vendimin me numër Nr.01-5052/18 të datës 22.11/18 për përzgjedhjen e kandidatit; Autorizimin e datës 19.01.2022 nga avokati për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme me provat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses për pozitën Auditore e brendshme; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër Nr.01-5420/18 të datës 10.12.2018 të ankueses; Vërtetimin me numër Nr.05-2966 të datës 27.10.2020 lidhur me përvojën e punës së ankueses në Telekomin e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 10.12.2021 dhe E-mailin zyrtar të datës 13.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas administrimit të provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: NJAB 03/13 të datës 18.11.2013 është e punësuar në pozitën e punës Auditore e Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Zëvendësuesja e Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u thirrur në dispozitat e nenit 61 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 3 nën aragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 4 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil, e në zbatim të Vendimit Nr.1488/2021 të datës 28.12.2021 të Sekretares së Përgjithshme, me datë 31.12.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.1504/2021, për lirim nga Shërbimi Civil, sipas të cilit vendim ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kundër vendimit për ndërprerje të marrëdhënies se punës, ankuesja me datë 26.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi me numër protokolli 1504/2021 i datës 31.12.2021 i Zëvendësuesit të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Vendimi Nr.1488/2021 i datës 28.12.2021 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. E njëjta kërkon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të shfuqizohen Vendimi Nr.1488/2021 i datës 28.12.2021 dhe Vendimi me numër protokolli 1504/2021 i datës 31.12.2021 dhe të obligohet Sekretari i Përgjithshëm që ta kthejë ankuesen në pozitën e mëparshme si Auditore e Brendshme apo në pozitë ekuivalente në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe rrjedhimisht ka konstatuar se i njëjti me kapitullin e pestë (V) ka rregulluar çështja e përfundimit të marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht me nenin 59 të këtij ligji, është përcaktuar se Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, përfundon si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirim nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj.

Me dispozitat e nenit 60 të këtij ligji përcaktohet se: 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.1. nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 1.2. nëpunësi humb shtetësinë apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.3. plotësohet mosha për pensionim; 1.4. konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit; 1.5. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, për mbajtjen e burgut efektiv për tre (3) muaj e më tepër.

Me dispozitat e nenit 61 përcaktohet se: 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon me lirim nga Shërbimi Civil, në këto raste: 1.1. për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit për të pranuar transferimin, sipas neneve 53 dhe 54 të këtij ligji; 1.2. kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit; 1.3. pas dy vlerësimeve "jo kënaqshëm", për dy vjet radhazi, të rezultateve në punë; 1.4. kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionim të parakohshëm, sipas këtij ligji; 1.5. kur nëpunësi civil gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shumangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozitë tjetër nuk do të mënjanonte endjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit; 1.6. kur nëpunësi i kategorisë së lartë drejtuese anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike; 1.7. në çdo rast tjetër, të parashikuar me ligj.

Ndërsa, me nenin 62 paragrafi 1 përcaktohet se: 1. Nëpunësi civil lirohet nga Shërbimi Civil edhe kur jep dorëheqjen nga detyra. Përveç mënyrave dhe kushteve të përcaktuara si me lartë, përfundimi i marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil, bëhet edhe për shkak të largimit nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore, siç përcaktohet me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotësimin të kushteve ligjore për përfundimin e marrëdhënies se punës, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë dhe ka gjetur se ankuesja



sipas Vendimit të datës 27.12.2018 të protokolluar me numër 1026 me datë 18.12.2018, të Zyrtarit Kryesor Administrativ, me datë 27.12.2018 ka pezulluar në mënyrë të dakorduar statusin e nëpunësit civil - marrëdhënien e punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, deri në përfundimin e ushtrimit të mandatit/kontratës si Zyrtare e Auditimit të Brendshëm në Telekomin e Kosovës Sh.A, gjegjësisht deri me datë 06.12.2021.

Po ashtu, Kolegji ka gjetur së ankuesja përmes e-mailit të datës 02.12.2021 ka njoftuar organin e punësimit lidhur me përfundimin e periudhës se pezullimit të dakorduar me datë 06.12.2021 dhe së e njëjta do të kthehet në vendin e punës si Auditore e Brendshme duke filluar nga data 07.12.2021. Ankuesja përsëri me datë 08.12.2021 i është drejtuar me e-mail organit të punësimit duke njoftuar të njëjtin se e ka filluar punën me datë 07.12.2021 dhe ka kërkuar që t'i aktivizohet e-maili zyrtar, të futet në listën e pagave dhe të pajiset me inventar të nevojshëm për ushtrimin e detyrës se Auditorit të Brendshëm.

Zëvendësuesja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në shkresën e datës 09.12.2021, drejtuar ankueses, nuk e ka kontestuar ekzistimin e kërkesës për pezullim, dhe rrjedhimisht vendimin për pezullim të dakorduar të marrëdhënies se punës, mirëpo e njëjta e ka njoftuar ankuesen se është plotësuar pozita e Auditorit të Brendshëm në Divizionin e Auditimit të Brendshëm dhe se organi i punësimit është duke shqyrtuar mundësinë e sistemimit në një pozitë ekuivalente sipas pikës 3 të Vendimit me numër protokoll 1026 të datës 28.12.2018, dhe është kërkuar nga ankuesja të mos paraqitet në punë deri në njoftimin e radhës.

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 28.12.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.1488/2021, përmes të cilit ka anuluar Vendimin me numër protokoll 1026 të datës 28.12.2018, për pezullim të dakorduar, me arsyetimin se vendimi për pezullim të dakorduar të marrëdhënies se punës është nxjerr në kundërshtim me ligjin material, gjegjësisht Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ndërsa Zëvendësuesja e Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Personelit, me datë 31.12.2021 ka nxjerrë Vendimin Nr.1504/2021 për lirim nga Shërbimi Civil, sipas të cilit vendim ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht, Kolegji ka gjetur se Vendimi Nr.1504/2021 i datës 31.12.2021 për lirimin e ankueses nga Shërbimi Civil është nxjerr në zbatim të Vendimit Nr.1488/2021 të datës 28.12.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, mirëpo sipas vlerësimit të Kolegjit ky vendim nuk ka mundur të jetë bazë për lirimin e ankuesit nga shërbimi Civil, sepse një gjë e tillë nuk përben fakt ligjor dhe si i tillë nuk është parashikuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në parim nuk e konteston kompetencën e organit të punësimit për anulimin dhe shfuqizimin e akteve administrative, në rast kur vlerëson së të njëjtat nuk janë në pajtueshmëri me ligjin, kompetencë kjo e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo Kolegji konstaton se Vendimi Nr.1488/2021 i datës 28.12.2021 për anulimin e vendimit për pezullim të dakorduar të ankueses krijon pasoja juridike vetëm në raport me ligjshmërinë e vendimit për pezullimin e dakorduar, e jo lidhur me vlefshmërinë e Akt Emërimit dhe rrjedhimisht me statusin e nëpunësit civil të ankueses.

Kështu që bazuar si me lartë, Kolegji konstaton se Zëvendësuesja e Menaxherit të Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes se Vendimit Nr.1504/2021 të datës 31.12.2021 për lirimin e ankueses nga Shërbimi Civil nuk ka zbatuar drejt ligjin material, sepse në rastin e ankueses humbja e statusit të nëpunësit civil është bërë pa u përmbush asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 60, 61 dhe 62 ndërlidhur me nenin 59 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, kështu



që vendimi për lirim të ankueses nga shërbimi Civil është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 59 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si i tillë ky vendim bie në kundërshtim edhe me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj pretendimi ankimor i ankueses lidhur me shkeljet e ligjit material është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marr parasysh se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative, ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor lidhur me shkeljet procedurale dhe vlerëson se vendimi i kontestuar nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e në këtë kuptim rezulton se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar.

Kolegji konstaton se Vendimi Nr.1504/2021 i datës 31.12.2021 për lirim të ankueses nga Shërbimi Civil, për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe dispozitave procedurale të cekura si me lartë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, obligohet organi i punësimit, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për kthimin e ankueses në pozitën e Auditorës së Brendshme sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: NJAB 03/13 të datës 18.11.2013 apo në pozitë ekuivalente në rast se pozita e Autori të Brendshëm është plotësuar.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.66/2022**

Ardita Perçaku-Shyti

Ardita Perçaku-Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

